



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-010
Prishtinë, më 29 mars 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 29 MARS 2011

Në mbledhje morën pjesë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga Grupet Parlamentare: Ibrahim Makolli, Ardian Gjini, Sasha Rashiq dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe
NDI: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Gjithashtu, kryesuesi i njoftoi anëtarët e Kryesisë se kryetari i Kuvendit gjendet për vizitë zyrtare në Hungari, bashkë me dy kryetarë të grupeve parlamentare.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 22 mars 2011,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 22 mars 2011

Kryesia miratoi pa vërejtje Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 22 mars 2011.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare më 31 mars 2011

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se Kuvendit duhet ta miratojë Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës para datës 31 mars 2011. Nënkyetarët e Kuvendit kërkuan që të ftohet kryesuesja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, për t'i informuar lidhur me përgatitjet e këtij komisioni, para se të caktohet mbledhja plenare më 31 mars 2011, ngase sipas rregullave procedurale, raportet e komisioneve parlamentare duhet t'i përgatisin raportet tri ditë para se të mbahet mbledhja plenare.

Ndërkohë, kryesuesja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadërgjonaj, i informoi nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare për punën e këtij komisioni. Ajo tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa gjatë ditës së sotme do ta përfundojë raportin për Projektligjin për buxhetin e vendit, për vitin 2011, ndërsa nesër edhe komisionet e tjera mund t'i përgatisin raportet e tyre.

Pas këtyre informacioneve, Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet më 31 mars 2011, duke filluar në orën 11:00, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Kërkesa e Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, që ta shqyrtojë kërkesën e Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për uljen e taksës menaxhuese dhe Kuvendit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.2 Raporti i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2010

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, që ta shqyrtojë Raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2010, dhe Kuvendit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.3 Raporti i Agjencisë Kundër Korrupsionit, për vitin 2010

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, si komision funksional, që ta shqyrtojë Raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, për vitin 2010, dhe Kuvendit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.4 Propozimi për guvernator të Bankës Qendrore të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, që ta shqyrtojë Propozimin e Panelit Vlerësues të kandidatëve për guvernator të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.5 Propozimi për debat parlamentar për masakrën në Burgun e Dubravës

Kryesia vendosi që këtë çështje ta shqyrtojë në njërën nga mbledhjet e radhës të Kryesisë. Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kërkohet nga deputetit Nait Hasani që këtij propozimi të kërkesës t’i bashkëngjitet një dokument, deklaratë ose rezolutë për miratim në Kuvend, pastaj Kryesia e Kuvendit do të vendos për datën e mbajtjen së debatit parlamentar në Kuvend.

Pikatë shtesë:

1. Vendimi për organizimin e Programit hyrës për deputetët e rinj të Kuvendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, mori këtë:

VENDIM

1. Organizohet Programi hyrës për deputetët e zgjedhur për herë të parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me dt. 04 dhe 05 prill 2011.
2. Shpenzimet e organizimit të Programit do të mbulohen në tërësi nga Kuvendi.

2. Vendim për pritjen e delegacionit të Kuvajtit në Kosovë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, mori këtë:

VENDIM

1. Kryesia e Kuvendit do të jetë mikpritëse e delegacionit të Asamblesë Nacionale të Kuvajtit, prej dt. 30 mars - 02 prill 2011.
2. Të gjitha shpenzimet e qëndrimit, akomodimit, drekat dhe darkat zyrtare, që do të dalin me rastin e pritjes dhe përcjelljes së delegacionit të Grupit të Miqësisë Ndërparlamentare të Kuvajtit, përballohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:05 minuta.

Nënkryetari i Kuvendit,

Xhavit HALITI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.